

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	00Nr.Br.157/2022	Data Datum: 31.10.2022	

Që Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 40.2 pika c) të Ligjit për vetëqeverisjen e lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008) dhe nenit 33.1 pika 3. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur më datë: 31.10.2022, Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga THV 2019, 2020 dhe 2021 në vitin 2022 dhe nxjerri këtë:

V E N D I M

MBI BARTJEN E MJETEVE BUXHETORE NGA VITI 2019, 2020 DHE 2021 NGA TË HYRAT VETANAKE TË PA SHPENZUARA NË VITIN 2022

MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës së Istogut për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitet 2019, 2020 dhe 2021 për shpenzim në vitin fiskal 2022, vlera e mbetur prej: 12,987.00 €, si në vijim:

I. Kategoria ekonomike Shpenzimeve Kapitale:

- Shuma prej 12,987.00€, të bartet në kategorinë Ekonomike Shpenzimeve Kapitale, për projektin "Ndërtimi i sistemit të ri të ujësjellësit dhe gjelbërimit", projekt i ri, në programin Planifikimi Urban dhe Mjedisi me kod, 0620 nën-programi Planifikimi Hapsinor dhe Rregullativ - Istog me kod 66090.

2. Autorizohet Drejtori për Buxhet e Financa dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) që ndryshimin dhe plotësimin e bartjes së mjeteve financiare, me të gjitha dokumentet përcjellëse të miratuara në Kuvendin e Komunës së Istogut, ta dërgojë në Ministrinë e Financave për procedim të mëtejshëm.

3. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesën: Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Departamenti i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, Departamenti i Përgjithshëm i Thesarit në Prishtinë, Kryetari i Komunës, Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.


 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
 Urales-Izlazim
 00 Nr. - 039 - 93 Data 04.11.2022
 Br: Datum
 ISTOG-ISTOK

Kryesuesi i Kuvendit,
 z. Enver Rugova

